



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 162, datë 31.08.2023

**PËR
LICENCIMIN E SUBJEKTIT “AUTOMOBILE ASSOCIATION OF ALBANIA”
SH.P.K., PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME, NË
EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A., DHE
MIRATIMIN E ZJ. ALKETA SELIMI PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENTIT NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SUBJEKTIT
“AUTOMOBILE ASSOCIATION OF ALBANIA” SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e subjektit “Automobile Association of Albania” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.**
- 2. Miratimin e zj. Alketa Selimi për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jojetës, në emër dhe për llogari të subjektit “Automobile Association of Albania” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**